

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË "ALBANIAN ART FOUNDRY " SHPK**

Sot më datë 15/01/2025, palët e mëposhtme:

**Ilmi Lala**, atësia Halit, amësia Hasie, shtetas shqiptar, lindur në Qaf-Murrë dhe banues në Kamëz me adresë Rr.BLV Nënë Tereza: Nd 556: H 4: njësia Administrative 1030, Kamëz, gjendja civile i martuar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili identifikohet me pasaportën me nr.BE3906357 me numër personal H80819154N.

shpreh vullnetin e tij për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "**ALBANIAN ART FOUNDRY**" sh.p.k. si më poshtë vijon:

**1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria "**ALBANIAN ART FOUNDRY**" sh.p.k, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar", shkurtimisht SHPK.

**2. Ortakët themelues**

**Ilmi Lala**, atësia Halit, amësia Hasie, shtetas shqiptar, lindur në Qaf-Murrë dhe banues në Kamëz me adresë Rr.BLV Nënë Tereza: Nd 556: H 4: njësia Administrative 1030, Kamëz, Tiranë, gjendja civile i martuar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili identifikohet me pasaportën me nr.BE3906357, me numër personal H80819154N.

**3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "**ALBANIAN ART FOUNDRY**" sh.p.k. do të jetë:

- Studio Arti, krijimtari artistike, fonderi derdhje metaleve, restaurim i veprave të artit, import-eksport të lëndeve të para, produkteve artistike gjysëm të gateshme si dhe të gateshme.
- Çdo aktivitet tjetër që mund të kryejë një shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**4. Selia e shoqërisë**

Selia e Shoqërisë "**ALBANIAN ART FOUNDRY**" sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën:

Tirane Ndraq MENIK Komuna Ndraq, Fshati Mënik, Godinë 1 Katëshe pranë Firmës "W-Ben".

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

## **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## **6. Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontributë në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

## **7. Drejtimi dhe Administrimi**

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**ALBANIAN ART FOUNDRY**” sh.p.k është **Z. Ilmi Lala**

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtar “**ALBANIAN ART FOUNDRY**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## **8. Shpërbërja dhe likuidimi**

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtar mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

### **Ortaku i vetëm**

**Z. Ilmi Lala**

Z. Ilmi Lala

